



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:047568

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06728849

P.nr.122/2022

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit B.D. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Falsifikimi i dokumenteve* nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.332/22 e datës 29.03.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e publik të mbajtur me datë 15.01.2024, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Albana Parduza, i pandehuri B.D. dhe mbrojtësi sipas autorizimit av. Kada Bunjaku Përçuku, më datën 15.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.01.2025 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B.D. nga i ati U..., e ëma S..., e gjinisë D... data e lindjes ... në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer Fakultetin e Edukimit, Fakultetin Filozofik – dega e Psikologjisë, mësues klase në shkollën fillore “Liria” në fshatin ..., i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

### ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 14.11.2021, në Shkollën Fillore “Lirija” në fshatin Strovç, komuna e Vushtrrisë, megjithëse ishte në gjendje të kuptonte domethënien e punës se tij dhe të menaxhonte veprimet e tij, i vetëdijshëm për punën e tij dhe duke dashur të bënte atë, ai përdori në mënyrë të paligjshme një kartë false si një kartë vëzhgimi që dyshohet si ishte lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Vushtrrisë, kështu që B.D. në mëngjes në ora 07:00 është paraqitur me kartelë si vëzhgues para Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndonëse nuk ka mundur të jetë vëzhgues për shkak se ka qenë kandidat

për këshilltar në Lidhjen Demokratike të Kosovës, raundi i parë dhe pas ekzaminimit u konstatua se karta në emër të B.D.t ishte e falsifikuar.

- Me këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPK-së, si dhe nenit 242, 320, 322, 364, 449 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

Të pandehurit: B.D. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind (500) euro si dhe DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit me rastin e shpalljes së aktgjykimit i është zëvendësuar në DËNIM ME GJOBË në shumën prej tetëqind (800) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon ose nuk mund të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.332/22 e datës 29.03.2022, kundër të pandehurit B.D. nga fshati ..., komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale *Falsifikimi i dokumenteve* nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 31.05.2023 në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit Ajtene Zoni dhe i pandehuri B.D..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin se në afat prej 30 ditësh mund të paraqes, kundërshtimet e tij për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës.

I pandehuri B.D. me anë të mbrojtëses sipas autorizimit av. Kada Bunjaku Përçuku me datë 13.06.2023 pranë kësaj gjykate ka paraqitur kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të

aktakuzës, të cilin kërkesë gjykata konform dispozitave të KPPK-së, respektivisht nenit 244 par.2 të KPPK-së me datë 14.06.2023 i'a ka dërguar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për përgjigje, Prokuroria Themelore në Mitrovicë në afatin e paraparë ligjor, respektivisht me datë 21.06.2023 ka kthyer përgjigje lidhur me pretendimet e avokates mbrojtëse.

Gjykata me datë 28.08.2023 ka nxjerrë aktvendim me të cilin kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave të parashtruar nga i pandehuri me anë të avokates mbrojtëse Kada Bunjaku Përçuku e ka vlerësuar si të pa bazë, ku ky aktvendim pas ankesës së avokates mbrojtëse me aktvendimin PN.nr.1210/23 të datës 26.12.2023 është anuluar nga Gjykata e Apelit e Kosovës 26.12.2023 dhe çështjen penale e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata me datë 10.01.2024 duke vendosur në rivendosje, e duke u bazuar edhe në rekomandimet e Gjykatës së Apelit ka nxjerrë aktvendim ku kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave e ka vlerësuar si të pa bazuar, i cili aktvendim pas kundërshtimit nga ana e të pandehurit me anë të mbrojtësit sipas autorizimit është vërtetuar dhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.nr.185/24, e datës 18.03.2024.

Gjykata ka cekuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 30.10.2024 në të cilën seance pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurës së shtetit në pajtim me dispozitat e nenit 320 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën të njëjti i jepet mundësia të pranojë fajësinë apo të deklarojë i pafajshëm, ku pasi që gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin lidhur me favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten të pafajshëm. Gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor ku palët janë deklaruar lidhur me fjalën hyrëse dhe janë administruar provat personale, përkatësisht janë marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar nga prokuroria A.J. dhe B.G..

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 02.12.2024 në të cilën seance gjykata ka vazhduar administrimin e provave personale ku në cilësinë e dëshmitarit janë marrë në pyetje përfaqësuesja nga KQZ E.A.M. dhe G.M..

#### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 15.01.2025, i pandehuri ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se e pranon fajësinë, i vjen keq për atë që ka ndodhur, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë këtë vepër penale dhe ka shtuar se më herët nuk ka ra ndesh me ligjin.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe vjen pas konsultimit me mbrojtësin e tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri është vërtetuar në tërësi aktakuza që i vihet në barë, ndërsa lidhur me rrethanat ka deklaruar se i propozon gjykatës që të marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, fillimisht duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e

përcaktuara në nenin 69 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit të i shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Avokatja mbrojtëse lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi i saj, pasi që ky pranim i fajësisë vjen pas konsultimit me të njëjtën si avokate mbrojtëse. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke qenë se i mbrojturi i saj e pranoj fajësinë, gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit i propozon që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë, karakteristikat personale të mbrojturit të saj, respektivisht faktin se i njëjti nuk ka ra ndesh më herët me ligjin, është mësimdhënës dhe me pagën e tij e mban familjen e tij, i njëjti ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë kohës dhe atë qysh nga marrja në pyetje në polici e deri tek shqyrtimet gjyqësore të mbajtura, kërkesë faljen publike dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej më vepra penale, andaj gjykatës i ka propozuar që të i merr parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese dhe njeherit të zbatoj institutin e zbutjes së dënimit me rastin e vendosjes, po ashtu ka shtuar se edhe nga vet fjala përfundimtare e prokurores se shtetit u konstatua se nuk ka asnjë rrethane rënduese në veprimet e të mbajturit të saj.

I pandehur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit mbrojtës.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-BD-0986, i datës 14.11.2021, raporti policor, i datës 14.11.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.D., i datës 14.11.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin A.J., i datës 14.11.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin B.G., i datës 02.12.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin F.S., i datës 03.12.2021, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 14.11.2021, fotoalbumi në shtojce i perbere nga 8 fotografi, lista e vëzhguesve – Vushtrri dhe raporti i ekspertimit me numër të referencës AKF/2021 – 3554/2021 – 3427, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose ndonjë gabim faktik.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri B.D. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, ka kryer veprën penale *Falsifikimi i dokumenteve* nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 390 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale *Falsifikimi i dokumenteve* e kryen “*Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor*

*dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.”, ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale ku është përcaktuar se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.”.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, rrethanat personale të tij, përkatësisht se i njëjti është prind i dy fëmijëve dhe është mbajtës i familjes dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore që paraqesin tek qytetarët këto vepra, karshi të të drejtave të tyre kushtetuese për zgjedhjen e institucioneve demokratike të vetëqeverisjes lokale në mënyrë të lirë e të pavarur.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro si dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit e konform neni 44 të KPRK-së i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### *Arsyet lidhur shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të neni 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të neni 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Numri i lëndës: 2022:047568  
Datë: 20.01.2025  
Numri i dokumentit: 06728849

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.122/2022,  
datë 20.01.2025

GJYQTARI  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.